



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

RrGGK uron Nënkryetaren e posazgjedhur në Kuvendin e Kosovës, zn. Aida Dërguti

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) uron zn. Aida Dërguti për zgjedhjen e saj në pozitën e Nënkryetares së Kuvendit të Kosovës, duke u bërë kështu gruaja e parë që mban këtë pozitë në Kryesinë e Kuvendit të Kosovës.

RrGGK konsideron se zgjedhja e zn. Dërguti në pozitën e Nënkryetares së Kuvendit të Kosovës është shenjë shprese për rëndësinë e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje në Kosovë. Ne e dimë që ajo do të vazhdojë punën e saj në përfaqësimin e interesave të grave dhe vajzave në proceset vendimmarrëse në Kosovë, në krijimin e politikave dhe ligjeve, si dhe në drejtim të avancimit të barazisë gjinore.

Në seancën e sotme të Kuvendit të Kosovës, zn. Aida Dërguti u zgjodh Nënkryetare e Kuvendit me 67 vota për, një abstenim dhe një kundër. Sipas Rregullores së Kuvendit të Kosovës, për zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit duhen së paku 61 vota.

Misioni i Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës (RRGGK) është të përkrahë, mbrojtë dhe promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave anembanë Kosovës, pa marrë parasysh bindjet e tyre politike, religjionin, moshën, nivelin e arsimit, orientimin seksual apo aftësitë e kufizuara. RrGGK përmbush misionin e vet përmes këmbimit të përvojave dhe informatave, partneriteteve dhe rrjetëzimit, hulumtimeve, avokimit dhe ofrimit të shërbimeve. Si Rrjet i 89 organizatave të grave nga të gjitha grupet etnike në tërë Kosovën, RrGGK avokon në emër të grave kosovare në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.

PRESS

www.womensnetwork.org • Hajdar Dushi St. C-2 II/8, 10000 Prishtina, Kosovo • +381 (0) 38 245 850 • info@womensnetwork.org